



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 630/2 Prot.

Vlorë më, 11.03 2026

VENDIM

Nr. 13, datë 11.03.2026

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES SË ORGANIZIMIT, FUNKSIONIMIN DHE
KOMPETENCAT E KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM NË UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; të nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; të nenit 13, pika 22 dhe nenit 127, pika A, të Rregullores së Brendshme të UV-së; si dhe duke iu referuar shkresës nr. 675, prot., datë 10.03.2026, të Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor, Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 11.03.2026,

VENDOSI:

1. Të miratohet Rregullorja për organizimin, funksionimin dhe kompetencat e Komitetit të Etikës në Kërkim në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, sipas materialit bashkëlidhur, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtoria e Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët.
3. Ky vendim u përcillet për njoftim njësisë kryesore të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Administratorit të UV-së, Drejtorisë së Kërkimit, Zhvillimit dhe Marrëdhënieve me të Tretët, Zëvendësrektorit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor dhe Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmëse Akadematike, për shpallje në faqen web të vendimit dhe për realizimin e njoftimeve përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF. DR. AURELA SALIAJ

[Signature]
[Stamp: REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" - VLORE]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

RREGULLORE

PËR

ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE KOMPETENCAT E

KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM

NË

UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË



Miratuar me Vendim të Senatit Akademik nr.13, dt. 11.03.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

Kjo rregullore përcakton organizimin, përbërjen, kompetencat dhe mënyrën e funksionimit të Komitetit të Etikës në Kërkim Shkencor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, me qëllim garantimin e respektimit të parimeve të etikës dhe integritetit në kërkimin shkencor që zhvillohet në UV.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet në:

- Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë";
- Statutin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë;
- Rregulloren e Përgjithshme të Universitetit;
- Parimet ndërkombëtare të integritetit në kërkimin shkencor.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për:

- personelin akademik dhe kërkimor të universitetit;
- studentët e ciklit Master dhe Doktoratë;
- projektet kërkimore të realizuara në popullatën dhe brenda infrastrukturës së Universitetit;
- botimet UniVlora: buletinet, revistat shkencore, monografite etj.

KREU II
PARIMET KU BAZOHET DHËNIA E LEJES ETIKE PËR KËRKIMIN SHKENCOR

Neni 4
Parimet themelore të kërkimit shkencor në UV

1. *Parimet e përgjithshme:* Kërkimi shkencor në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë zhvillohet në përputhje me parimet:
 - integriteti akademik;
 - objektiviteti dhe paanshmëria;
 - transparenca;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

- përgjegjësia shkencore;
 - respektimi i të drejtave të njeriut;
 - mbrojtja e të dhënave personale dhe konfidencialiteti.
2. *Integriteti në kërkim:* Kërkuesit duhet të garantojnë:
- respektimin e standardeve të publikimit shkencor.
 - raportim të saktë të rezultateve
 - citim korrekt të burimeve
 - shmangien e plagjiaturës dhe manipulimit të të dhënave
3. *Mbrojtja e pjesëmarrësve në kërkim:* Çdo kërkim që përfshin pjesëmarrës njerëzorë duhet të garantojë:
- informimin dhe pëlqimin e lirë të pjesëmarrësve
 - respektimin e privatësisë dhe dinjitetit të tyre
 - mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Kushtet Etike për Miratimin e Projekteve Kërkimore

1. *Integriteti dhe ndershmëria shkencore*

Projekti duhet të garantojë që:

- kërkimi zhvillohet në mënyrë të ndershme dhe transparente;
- nuk ka manipulim ose falsifikim të të dhënave;
- burimet dhe literatura citohen në mënyrë të saktë;
- respektohen standardet e publikimit shkencor dhe shmanget plagjiatura.

2. *Qartësia shkencore dhe metodologjia*

Projekti duhet të ketë:

- objektiva të qarta kërkimore;
- metodologji të përshtatshme dhe shkencërisht të justifikuar;
- përshkrim të qartë të metodave të mbledhjes dhe analizës së të dhënave.

3. *Respektimi i të drejtave të njeriut*

Nëse projekti përfshin pjesëmarrës njerëzorë duhet të garantojë:

- respektimi i dinjitetit dhe të drejtave të tyre;
- mbrojtja e integritetit fizik dhe psikologjik;
- pjesëmarrja vullnetare në kërkim.

4. *Pëlqimi i informuar (Informed Consent)*

Pjesëmarrësit duhet të:

- informohen për qëllimin e kërkimit;
- informohen për mënyrën e përdorimit të të dhënave;
- kenë të drejtë të tërhiqen nga kërkimi në çdo moment;
- japin pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar.

5. *Mbrojtja e të dhënave personale*

Projekti duhet të garantojë:

- konfidencialitetin e informacionit;
- anonimizimin e të dhënave kur është e nevojshme;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

- përdorimin e të dhënave vetëm për qëllime kërkimore;
 - respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
6. *Minimimi i rreziqeve*
Kërkimi duhet të:
- shmangë rreziqet për pjesëmarrësit;
 - minimizojë çdo rrezik të mundshëm fizik, psikologjik apo social;
 - parashikojë masa mbrojtëse në rast rreziku.
7. *Mbrojtja e grupeve vulnerabël*
Në rast se kërkimi përfshin:
- fëmijë
 - persona me aftësi të kufizuara
 - pacientë
 - grupe sociale të ndjeshme
- duhet të sigurohen masa shtesë mbrojtëse dhe miratime përkatëse.
8. *Transparenca dhe përgjegjësia kërkimore*
Kërkuesit duhet të:
- financimin e projektit;
 - shmangin konfliktin e interesit;
 - raportojnë rezultatet në mënyrë të saktë dhe të plotë.
9. *Respektimi i pronësisë intelektuale*
Projekti duhet të:
- respektojë të drejtat e autorësisë;
 - shmangë përdorimin e paautorizuar të materialeve ose të dhënave;
 - garantojë citimin korrekt të burimeve.
10. *Përputhja me legjislacionin dhe rregulloret institucionale*
Projekti duhet të jetë në përputhje me:
- legjislacionin kombëtar për kërkimin shkencor;
 - rregulloret e universitetit;
 - standardet ndërkombëtare të etikës në kërkim.

Neni 6

Përbërja dhe kompetenca e grupit kërkimor

1. Çdo projekt kërkimor që paraqitet për vlerësim etik duhet të realizohet nga një grup kërkimor me kompetencë të përshtatshme shkencore dhe profesionale, në përputhje me objektivat dhe metodologjinë e projektit.
2. Grupi kërkimor duhet të përbëhet nga studiues që kanë kualifikim akademik dhe përvojë kërkimore në fushën përkatëse, duke garantuar realizimin e projektit sipas standardeve të integritetit dhe cilësisë shkencore.
3. Projekti duhet të ketë një drejtues kërkimor (Principal Investigator), i cili:
 - ka përgjegjësinë shkencore dhe etike për realizimin e projektit;
 - siguron respektimin e standardeve të etikës në kërkim;
 - koordinon aktivitetet e ekipit kërkimor dhe raportimin e rezultateve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

4. Përbërja e ekipit kërkimor duhet të sigurojë ekspertizën e nevojshme disiplinore dhe metodologjike, duke përfshirë, sipas rastit, specialistë të metodologjisë së kërkimit, analizës së të dhënave ose fushave të tjera relevante.
5. Roli dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të ekipit kërkimor duhet të jenë të përcaktuara qartë në projektin kërkimor.
6. Në rast se projekti përfshin studentë të ciklit Master ose Doktoratë, ata duhet të veprojnë nën mbikëqyrjen e një drejtuesi akademik dhe në përputhje me rregulloret e universitetit për kërkimin shkencor.
7. Anëtarët e ekipit kërkimor janë të detyruar të respektojnë parimet e integritetit akademik, transparencës dhe përgjegjësisë në kërkim, si dhe të deklarojnë çdo konflikt të mundshëm interesi.
8. Komiteti i Etikës në Kërkim mund të kërkojë plotësimin ose ndryshimin e përbërjes së ekipit kërkimor, nëse vlerëson se ekspertiza e nevojshme për realizimin e projektit nuk është e mjaftueshme.

Neni 7

Rastet kur kërkohet dhe kur nuk kërkohet miratimi etik

1. Rastet kur kërkohet miratimi etik

Miratimi etik nga Komiteti i Etikës në Kërkim Shkencor është i detyrueshëm kur projekti kërkimor përfshin një ose më shumë nga situatat e mëposhtme:

- a) kërkime që përfshijnë pjesëmarrës njerëzorë, si intervista, anketa, fokus-grupe, eksperimente ose forma të tjera ndërveprimi me individë;
- b) kërkime që përfshijnë mbledhjen, përdorimin ose përpunimin e të dhënave personale, veçanërisht kur ato janë të identifikueshme ose sensitive;
- c) kërkime që përfshijnë grupe vulnerabël, si të mitur, pacientë, persona me aftësi të kufizuara ose kategori të tjera sociale që kërkojnë mbrojtje të veçantë;
- d) kërkime që përfshijnë eksperimente, ndërhyrje ose manipulime të kushteve të studimit që mund të kenë ndikim fizik, psikologjik ose social mbi pjesëmarrësit;
- e) projekte kërkimore që mund të paraqesin rrezik për mirëqenien, dinjitetin ose privatësinë e individëve;
- f) projekte kërkimore të realizuara në kuadër të programeve ose fondeve kombëtare dhe ndërkombëtare, për të cilat kërkohet miratim etik institucional.

2. Rastet kur miratimi etik nuk kërkohet

Miratimi etik nuk është i nevojshëm për projektet kërkimore që:

- a) bazohen ekskluzivisht në studime teorike, analizë literaturë ose rishikim bibliografik;
- b) përdorin të dhëna statistikore ose databaza publike, të cilat janë të anonimizuara dhe nuk përmbajnë të dhëna personale të identifikueshme;
- c) analizojnë dokumente publike, ligje, politika ose materiale arkivore që janë të aksesueshme publikisht;
- d) përfshijnë modele teorike, analiza matematikore, statistike ose kompjuterike, pa përfshirjen e drejtpërdrejtë të pjesëmarrësve njerëzorë;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

- e) përdorin materiale ose të dhëna që janë tashmë plotësisht të anonimizuara dhe nuk mund të lidhen me individë të caktuar.

3. Rastet që kërkojnë vlerësim paraprak

Në rastet kur ekziston paqartësi nëse një projekt kërkimor kërkon miratim etik, studiuesi mund të paraqesë një *kërkesë për vlerësim paraprak* pranë Komitetit të Etikës, i cili vendos nëse projekti duhet t'i nënshtrohet procedurës së plotë të vlerësimit etik.

Neni 8

Format e shkeljes së integritetit akademik

- Shkelje e integritetit akademik konsiderohet çdo veprim ose mosveprim që cenon parimet e ndershmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë në kërkimin shkencor dhe në veprimtarinë akademike.
- Format kryesore të shkeljes së integritetit akademik përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në:
 - Plagjiaturën*, që nënkupton paraqitjen e ideve, tekstit, të dhënave, rezultateve ose materialeve të një autori tjetër si punë origjinale, pa citimin dhe referimin e duhur të burimit;
 - Fabrikimin e të dhënave*, që nënkupton krijimin ose shpikjen e të dhënave, rezultateve ose evidencave kërkimore që nuk ekzistojnë në realitet;
 - Manipulimin ose falsifikimin e të dhënave*, që përfshin ndryshimin, modifikimin ose seleksionimin e qëllimshëm të të dhënave ose rezultateve për të arritur përfundime të caktuara;
 - Përdorimin e paautorizuar të materialeve kërkimore*, përfshirë përdorimin e ideve, metodave ose rezultateve të të tjerëve pa miratim ose pa citim;
 - Autorësinë e papërshtatshme*, që përfshin përfshirjen ose përjashtimin e padrejtë të personave nga lista e autorëve të një punimi shkencor;
 - Publikimin e shumëfishtë të të njëjtit material kërkimor*, pa referimin e duhur ose pa informimin e redaksive përkatëse;
 - Çdo veprim tjetër që bie ndesh me standardet e *etikës dhe integritetit në kërkim shkencor*.
- Shkeljet e integritetit akademik trajtohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë rregullore dhe në aktet e tjera të brendshme të universitetit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

KREU III

ORGANIZIMI I KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM

Neni 9

Statusi

Komiteti i Etikës në Kërkim Shkencor është organ kolegjal i ngritur në nivel institucioni.

Neni 10

Përbërja e Këshillit të Etikës në Kërkim

1. Komiteti i Etikës në Kërkim përbëhet nga 7 anëtarë:
 - a) zëvendësrektori për kërkimin shkencor (kryetar)
 - b) një personel akademik përfaqësues nga çdo njësi kryesore (4 anëtarë)
 - c) përgjegjësi i sektorit të kërkimit shkencor dhe projekteve (sekretar)
 - d) një student i ciklit të dytë ose të tretë të studimeve.
2. Kryetari i Komitetit dhe Përgjegjësi i sektorit të Kërkimit shkencor dhe Projekteve bëhen pjesë e Komitetit të Etikës në Kërkim si pasojë e detyrave funksionale që ushtrojnë në pozicionet administrative përkatëse.

Neni 11

Zgjedhja dhe Mandati i anëtarëve

1. Kandidatët për Komitetin e Etikës në Kërkim, përfaqësues të njësive kryesore dhe student, vetkandidohen dhe përzgjidhen me votim nga SA për një periudhë 5 vjeçare.
2. Kriteret e kandidimit të personelit akademik:
 - niveli akademik: kategoria Profesor ose PhD
 - eksperiencia në kërkim shkencor: drejtues projekti kërkim-zhvillimi në minimumi 2 (dy) projekte UV ose 1 (një) projekt kombëtar.
3. Kriteret e kandidimit për anëtarin student:
 - cikli i studimeve: i dytë ose i tretë
 - nota mesatare e ciklit paraardhës të studimeve: minimalisht 8
 - eksperiencia në kërkim shkencor: pjesëmarrës në një grup pune në projekt kërkim-zhvillimi ose autor i një teme diplome.
4. Pjesëmarrja në organe të tjera kolegjiale / detyra administrative nuk përbën pengesë për pjesëmarrje në Komitetin e Etikës në Kërkim.
5. Në rast dorëheqjeje ose pamundësie ushtrimi të detyrës, Senati Akademik emëron anëtarin zëvendësues.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

KREU IV

KOMPETENCAT DHE FUNKSIONIMI I KOMITETIT TË ETIKËS NË KËRKIM

Neni 12

Kompetencat e Këshillit të Etikës në Kërkim

1. Komiteti i Etikës në Kërkim të UV-së ka për kompetenca kryesore:
 - a) *dhënien e Lejeve Etike*, të cilat firmosen njëkohësisht nga Kryetari i Komitetit të Etikës dhe nga Rektori, për studime të zhvilluara:
 - në popullatën e studentëve dhe personelit të UV,
 - brenda infrastrukturës së UV-sëpavarësisht nëse këto projekte kërkim-zhvillimi zhvillohen nga personel dhe studentë të UV apo nga persona të tretë jashtë UV-së.
 - b) *verifikimin e integritetit, ligjshmërisë dhe etikës* së botimeve UniVlora, projekteve dhe punimeve shkencore, të zhvilluara në Universitetin 'Ismail Qemali' ose nga personeli i UV-së.
 - c) *përcaktimin e standarteve për pranueshmërinë e integritetit të punimit shkencor*: përqindjen maksimale të ngjashmërisë së punimit me burime të tjera dhe të përdorimit të AI.
2. Komiteti vepron mbi bazën Përgjegjshmërisë institucionale, transparencës dhe dokumentimit të plotë, përputhshmërisë me sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë (SBSC).
3. Vendimet e Komitetit të Etikës në Kërkim u bëhen të ditura dhe janë të detyrueshme për zbatim nga të gjitha njësitë kryesore / bazë të UV.
4. Gjetjet e shkeljeve të integritetit, ligjshmërisë dhe etikës nga Komiteti i Etikës në Kërkim përbëjnë indicie për marrjen e masave disiplinore dhe pengimin e financimit dhe marrjen e lejeve etike për zhvillimin e kërkimeve shkencore të mëtejshme nga të njëjtët persona.

Neni 13

Mënyra e Mbledhjes dhe Kuorumi

Komiteti nuk mund të marrë vendime pa një rregullsi formale:

- *Periodiciteti*: KEK mbledhet në mënyrë të rregullt (p.sh. një herë në muaj) ose sa herë që ka aplikime për shqyrtim.
- *Thirrja e mbledhjes*: Kryetari njofton anëtarët të paktën 3 ditë pune përpara, duke dërguar rendin e ditës dhe materialet shoqëruese.
- *Kuorumi*: Mbledhja quhet e vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve (50% + 1).

Neni 14

Vendimmarrja dhe Votimi

Për të shmangur bllokimet dhe për të garantuar paanshmërinë:

- *Votimi*: Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORË

- *Transparenca:* Votimi është i hapur, përveç rasteve kur kërkohet votim i fshehtë për çështje që prekin integritetin e personave specifikë.
- *Mendimi i Pakicës:* Anëtarët që votojnë kundër kanë të drejtë të bashkëngjisin mendimin e tyre të arsyetuar në procesverbal.

Neni 15

Menaxhimi i Konfliktit të Interesit

- *Vetëdeklarimi:* Çdo anëtar i KEK duhet të deklarojë në fillim të mbledhjes nëse ka konflikt interesi me një projekt kërkimor (p.sh. është bashkautor, udhëheqës i studentit, apo ka lidhje familjare me aplikuesin).
- *Përfshirja:* Nëse ekziston konflikti, anëtari duhet të largohet nga dhoma gjatë diskutimit dhe votimit për atë projekt specifik.

Neni 16

Procedura e dhënies së Lejeve Etike

1. Çdo projekt kërkimor që kërkon miratim etik paraqitet për shqyrtim pranë Komitetit të Etikës në Kërkim Shkencor përpara fillimit të aktiviteteve kërkimore.
2. Kërkesa për miratim etik paraqitet nga drejtuesi i projektit kërkimor (Principal Investigator) dhe duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës.
3. Dokumentacioni minimal për aplikim përfshin:
 - a) formularin e aplikimit për miratim etik të projektit kërkimor;
 - b) përshkrimin qëllimit të projektit dhe objektivave të kërkimit;
 - c) metodologjinë e kërkimit dhe planin e mbledhjes së të dhënave;
 - d) informacionin mbi përbërjen e grupit kërkimor dhe përgjegjësitë e anëtarëve;
 - e) deklarimin dhe dokumentacionin mbi mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin;
 - f) formularin e pëlqimit të informuar për pjesëmarrësit në kërkim, nëse projekti përfshin pjesëmarrës njerëzorë;
 - g) deklaratën për konflikt interesi të drejtuesit të projektit.
4. Kërkesa për miratim etik pas protokollimit dërgohet tek sekretari i Komitetit të Etikës në Kërkim, e skanuar.
5. Çdo kërkesë që vjen në Komitetin e Etikës në Kërkim kalon në këto faza:
 - a) *Verifikimi Administrativ:* Sekretaria e KEK sheh nëse dosja është e plotë (formularët, metodologjia, deklaratat).
 - b) *Caktimi i Relatorit:* Kryetari cakton një anëtar (ose dy) si *relatorë* nga anëtarët e KEK, të cilët e studiojnë projektin në thellësi dhe përgatisin një relacion përmbledhës për anëtarët e tjerë.
 - c) *Dëgjimi (opsional):* KEK mund të ftojë kërkuesin për të dhënë sqarime shtesë nëse projekti paraqet rreziqe etike komplekse.
6. Relatori shqyrton projektin në aspektin e:
 - o respektimit të parimeve të etikës në kërkim shkencor;
 - o mbrojtjes së të drejtave dhe dinjitetit të pjesëmarrësve në kërkim;





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

- mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidencialitetit;
 - përbërjes dhe kompetencës së grupit kërkimor;
 - përputhjes me legjislacionin dhe rregulloret institucionale.
7. Me ardhjen e relacionit mbi përmbushjen e kritereve etike të projektit, kryetari i KEK e kalon për shqyrtim në mbledhjen e radhës.
 8. Pas shqyrtimit të projektit dhe relacionit mbi të Komiteti i Etikës mund të vendosë:
 - a) miratimin etik të projektit kërkimor;
 - b) miratimin etik me rekomandime ose kërkesë për plotësim të dokumentacionit;
 - c) rishikimin e projektit dhe paraqitjen e tij të rishikuar;
 - d) mosmiratimin e projektit.
 9. Vendimi i Komitetit të Etikës në Kërkim i komunikohet aplikuesit me shkrim dhe dokumentohet në procesverbalin e mbledhjes.
 10. Ky proces nuk duhet të kalojë 10 ditë pune në total.
 11. Projekti kërkimor mund të fillojë vetëm pas marrjes së miratimit etik nga Komiteti i Etikës në Kërkim Shkencor.

Neni 17

Procedura e verifikimit të integritetit të punimeve origjinale

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë garanton respektimin e integritetit akademik dhe origjinalitetit të punimeve shkencore, duke zbatuar procedura të verifikimit për të parandaluar plagjiaturën dhe format e tjera të shkeljes së etikës në kërkim.
2. Çdo punim shkencor i realizuar në kuadër të aktivitetit akademik dhe kërkimor të universitetit, përfshirë artikuj shkencorë, projekte kërkimore, tema diplome, disertacione master dhe doktorate, i nënshtrohet verifikimit të integritetit akademik.
3. Autorët e punimeve janë përgjegjës për respektimin e rregullave të citimit dhe referimit të burimeve, si dhe për garantimin e origjinalitetit të kontributit të tyre shkencor.
4. Procesi i verifikimit të integritetit përfshin:
 - a) kontrollin e punimit për ngjashmëri me burime të tjera shkencore;
 - b) shkallën e përdorimit të AI
 - c) analizën e rezultateve të raportit të ngjashmërisë dhe përdorimit të AI;
5. Kontrolli i ngjashmërisë me burime të tjera dhe përdorimi i AI realizohet nëpërmjet platformave antiplagjiaturë në përdorim të UV-së, nga një grup i ngritur në nivel institucional, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren specifike për këtë qëllim.
6. Analiza e rezultateve të raportit të ngjashmërisë dhe përdorimit të AI bëhet sipas standarteve të përcaktuara paraprakisht prej KEK, të cilat bazohen gjerësisht në standardet ndërkombëtare të etikës në kërkim, Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe rregulloret e brendshme të universitetit.
7. Procedura e verifikimit të integritetit të punimeve është si vijon:
 - a) Kërkesa për kontrollin antiplagjiaturë drejtohet elektronikisht tek kryetari i KEK prej personave të interesuar: shefat e departamenteve për temat e doktoratës dhe masterave, administratorit të revistave shkencore për artikujt për publikim, pedagogëve që kërkojnë botim monografish etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

- b) Kërkesës i bashkangjitet elektronikisht materiali që kërkohet të verifikohet.
- c) Dokumentacioni i përcillet për verifikim komisionit të posatshtëm të ngritur për këtë qëllim nga Rektori i UV-së.
- d) Pas procesimit të materialit të dërguar për kontroll në platformat antiplagjiaturë, komisioni harton një raport ku paraqiten konstatimet e ngjashmërisë me burime të tjera dhe përdorimit të AI, si dhe bëhet analiza për pranueshmërinë e këtyre rezultateve, në bazë të përqindjeve standarte të përcaktuara paraprakisht nga KEK.
- e) Raporti i dërgohet shkresërisht Rektorit të UV-së, i cili ua bën me dije autorëve të punimit, si dhe autoriteteve që kërkuan verifikimin.

Neni 18

Procedura e trajtimit të rasteve të plagjiaturës

1. Dyshimet për plagjiaturë ose shkelje të tjera të integritetit akademik mund të paraqiten nga çdo anëtar i komunitetit akademik ose nga struktura të tjera të universitetit.
2. Çdo rast i dyshuar për plagjiaturë i nënshtrohet një verifikimi paraprak, i cili mund të përfshijë kontrollin e punimit përmes programeve të specializuara për analizën e ngjashmërisë së tekstit.
3. Në rast se nga verifikimi paraprak rezultojnë indicie për plagjiaturë, çështja i referohet Komitetit të Etikës në Kërkim Shkencor për shqyrtim të mëtejshëm.
4. KEK shqyrton dokumentacionin përkatës dhe mund të kërkojë:
 - sqarime nga autori ose autorët e punimit;
 - dokumentacion shtesë ose prova mbështetëse;
 - mendimin e ekspertëve të fushës përkatëse.
5. Pas shqyrtimit të çështjes, Komiteti i Etikës në Kërkim përgatit një raport dhe rekomandon masat përkatëse për organet drejtuese të universitetit.
6. Në rast se konstatohet plagjiaturë ose shkelje e integritetit akademik, mund të ndërmerren masa në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e universitetit.
7. Procesi i shqyrtimit të rasteve të plagjiaturës duhet të zhvillohet në mënyrë objektive, transparente dhe në respekt të parimeve të drejtësisë procedurale, duke garantuar të drejtën e autorit për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur argumentet e tij.


KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 19 Raportimi

1. Komiteti harton raport vjetor për:
 - numrin e projekteve të shqyrtuara;
 - llojin e vendimeve;
 - rastet e shkeljeve etike;
 - masat e marra





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI", VLORE

2. Ky raport përfshihet në Raportin Vjetor të UV-së.

Neni 20

Miratimi dhe hyrja në fuqi

Miratimi, hyrja në fuqi dhe ndryshimi i kësaj Rregulloreje bëhet me vendim të Senatit Akademik të UV-së.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK
PROF.DR. AURELA SALIAJ

A. Saliaj